



# Informacionet për personat mbi 16 vjeç me një sëmundje kronike, personat mbi 65 vjeç dhe gratë shtatzëna

Unë kam një sëmundje kronike ose një defekt të lindjes.

Unë jam 65 vjeç dhe më i madh. Unë jam shtatzënë.

COVID-19 është i rrezikshëm për ju.

Prandaj rekomandojmë: Të vaksinoheni me një vaksinë mARN.

Konsultohuni me mjeken ose mjekun tuaj.

## Pse është i rrezikshëm COVID-19 për mua?

COVID-19 mund të ketë pasoja të rënda dhe madje shumë të rënda për ju. Për shembull gulçim në rastin e pneumonisë. Pastaj ju duhet oksigjen dhe duhet të shkoni në spital. Mund t'ju duhet shumë kohë për tu rikuperuar. Nëse përkeqësoheni nga COVID-19, ju duhet të trajtoheni në Njësinë e Kujdesit Intensiv. Ju mund të keni nevojë për frymëmarrje artificiale. COVID-19 mund të dëmtojë edhe organet e tjera dhe ju mund të vdisni nga kjo.

## Për cilat sëmundje dhe defekte që nga lindja Zyra Federale e Shëndetit Publik rekomandon në veçanti vaksinimin ndaj Covid-19?

Ne rekomandojmë në veçanti vaksinimin e të gjithë personave 16 vjeç e lart me lloje të caktuara të sëmundjeve kronike më poshtë<sup>1</sup>:

- Presion i lartë të gjakut
- Sëmundje kardiovaskulare
- Diabet
- Sëmundje të mushkërive dhe të frymëmarrjes
- Kancer
- Sëmundje dhe terapi që dobësojnë sistemin imunitar
- Obezitet (BMI ≥ 35 kg/m<sup>2</sup>)
- Insuficencë renale
- Cirrozë e mëlçisë

Ne gjithashtu rekomandojmë që të vaksinoni të rriturit me Trisomie 21.

## Çfarë vlen, nëse jam shtatzënë ose dëshiroj të mbetem shtatzënë?

Gratë shtatzëna kanë një rrezik të dukshëm në rritje për ecuri të rënda në rastin e një sëmundjeje me Covid-19. Përveç kësaj, rreziku për një lindje të parakohshme është rritur ndjeshëm. Për këtë arsye duhet të vaksinoheni sa më shpejt që të jetë e mundur, nëse dëshironi të mbeteni shtatzënë.

Ju tashmë jeni shtatzënë dhe nuk keni bërë ende asnjë vaksinim përpara shtatzënisë? Atëherë ju rekomandojmë vaksinimin pas 12 javësh të shtatzënisë (d.m.th. pas tremujorit të 2. të shtatzënisë). Ai është themelor por edhe i mundshëm më herët në shtatzëni.

Nëse jeni shtatzënë ose planifikoni të mbeteni shtatzënë dhe keni pyetje rreth vaksinimit, flisni me mjeken tuaj, mjekun tuaj ose maminë tuaj.

## Është vaksinimi efikas dhe i sigurt?

Çdo vaksinë ka nevojë për miratim dhe rekomandim në Zvicër. Për ta bërë këtë, ajo duhet të plotësojë standarde të larta për sigurinë, efikasitetin dhe cilësinë. Agjencia Zvicerane për Produkte Terapeutike, Swissmedic, ka ekzaminuar dhe miratuar me kujdes vaksinat kundër COVID-19.

Ato janë të sigurta dhe efikase. Dhjetëra mijëra njerëz tashmë kanë marrë vaksinën mARN gjatë punës kërkimore. Ato janë të sigurta dhe efikase tek të moshuarit edhe me sëmundje kronike si dhe te gratë shtatzëna.

Disa miliarda njerëz janë vaksinuar me këto vaksina që nga miratimi. Profesionistët vazhdojnë të monitorojnë sigurinë dhe efikasitetin e vaksinave. Përfitimet nga përdorimi i vaksinës duhet të jenë shumë më të mëdha sesa rreziqet nga përdorimi i saj. Vetëm atëherë vaksina rekomandohet për përdorim në Zvicër.

Rreziku i efekteve anësore serioze pas vaksinimit është shumë më i vogël se rreziku i përparimit serioz të sëmundjes pas infektimit nga koronavirusi.

## Cilëve persona u rekomandohet cila vaksinë?

Të gjithë personave mbi 12 vjeç ne u rekomandojmë në përgjithësi vaksinimin me një vaksinë mARN. Këto vaksina ofrojnë mbrojtjen më të mirë të mundshme nga një sëmundje me Covid-19 dhe pasojat e saj të mundshme. Personave nën 30 vjeç u rekomandohet mundësisht vaksinimi me vaksinën nga Pfizer/BioNTech. Për fëmijët nga 5 deri 11 vjeç lejohet dhe rekomandohet vetëm vaksina apostafat për fëmijët nga Pfizer/BioNTech. Personat mbi 18 vjeç, të cilët për arsye mjekësore nuk mund të vaksinohen me vaksinat mARN ose i refuzojnë vaksinat mARN mund të vaksinohen edhe me vaksinën vektor të Janssen.

<sup>1</sup> Lista e hollësishme e sëmundjeve mund të gjendet në: *categories of persons at high risk*



Kujdes: Gratë shtatzëna dhe gratë që japin gji si dhe personat me një sistem të dobët imunitar duhet të vaksinohen mundësisht me një vaksinë mRNA.

### **Kush nuk duhet të vaksinohet?**

Ne nuk u rekomandojmë vaksinimin kundër COVID-19 me një vaksinë mRNA këtyre njerëzve:

- Njerëzve me alergji të rëndë të konfirmuar ndaj cilitdo përbërës të vaksinës veçanërisht glikolit të polietilenit (PEG) ose trometaminë (TRIS).  
Ju lutem konsultohuni me një alergologe, një alergolog<sup>23</sup>.
- Fëmijëve nën 5 vjeç. Deri më tani nuk ka të dhëna për vaksinimin në këtë grupmoshë.

### **Ku mund të vaksinohem?**

Qeveria federale ka hartuar një strategji dhe rekomandime për vaksinimin. Kantonet janë përgjegjëse për vaksinimin. Zbuloni në faqen e internetit ose në linjën e informacionit në kantonin tuaj [www.foph-coronavirus.ch/cantons](http://www.foph-coronavirus.ch/cantons) (anglisht), se ku mund të vaksinoheni. Ose pyesni mjekun apo farmacistin tuaj.

### **Sa shpesh duhet të vaksinohem?**

Për imunizimin bazë nevojiten normalisht dy vaksinime. Vaksinimin e dytë mund të bëni afërsisht katër javë pas vaksinimit të parë. Bëni të dyja vaksinimet. Vetëm atëherë mbroheni në mënyrën më të mirë. Nëse tashme kishit një infeksion të konfirmuar me koronavirusin, normalisht ju duhet vetëm një vaksinim me një vaksinë mRNA.

Ka përjashtime për persona posaçërisht të rrezikuar me sistem të dobësuar imunitar; pyesni tek mjekja ose mjeku juaj.

### **Për cilat persona rekomandohet pas katër muajsh një vaksinim përforcues me një vaksinë mRNA?**

Për të gjitha personat mbi 12 vjeç rekomandohet një vaksinim përforcues duke filluar 4 muaj pas imunizimit të plotë bazë (shih fletën udhëzuese «*Vaksinimi i përforcuar me një vaksinë mRNA*»).

Vaksinimi përforcues rekomandohet gjithashtu për gra shtatzëna që nga trimestri i dytë të shtatzënisë dhe për gra, që japin gji.

Vaksinat mRNA mbrojnë shumë mirë nga sëmundjet e rënda me shtrime në spital. Kjo mbrojtje mund të bie me kalimin e kohës në varësi të moshës dhe të variantit të virusit.

Mbrojtja nga një sëmundje e lehtë si dhe nga transmetimi i virusit bie në të gjithë personat me kalimin e kohës. Kjo mund të ndodhë më shpejt ose më ngadalë në varësi të variantit. Me anë të vaksinimit përforcues sistemi imunitar rikujtohet për virusin. Një mbrojtje e shtuar rikrijohet dhe zgjatet.

### **Ku mund të gjej më shumë informacion?**

Informacione të mëtejshme mbi vaksinimin kundër COVID-19 mund të gjenden në faqen e internetit të BAG: [www.foph-coronavirus.ch/vaccination](http://www.foph-coronavirus.ch/vaccination) (anglisht) Ose pyesni mjekun ose mjekun tuaj. Ose në farmacinë tuaj.

<sup>2</sup> Personat, të cilët për arsye mjekësore nuk lejohet të bëjnë vakcina mRNA, mund të vaksinohen në të gjitha rastet në marrëveshje me mjekun ose mjekun me vaksinën vektor të Janssen.

<sup>3</sup>

